




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine/Ministry of Economy and Environment

REFERENCË:	
DATE:	03.07.2020
PËR/ ZA/ TO	Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike
CC:	Besnik Krasniqi, Udhëheqës i NJPMNP
NGA/ OD/ FROM:	Z. Blerim Kuçi, Ministër i Ekonomisë dhe Ambientit 
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT	Kërkesë për BD të Ndërmarrjeve Publike

Të nderuar,

Mbështetur në nenin 5.1 dhe nenin 37 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Kërkesën e Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike Nr.696, të datës 03.07.2020, në cilësinë e Aksionarit (Qeverisë) ju drejtohem me kërkesë që të pezulloni të gjitha proceset e rekrutimit, për arsyet e cekura në kërkesën e NJPMNP.

Kërkesa për pezullimin e këtyre proceseve ka për qëllim të shmangen dëmet financiare në Ndërmarrjet Publike si pasojë e kontesteve të ngritura në procedura administrative dhe gjyqësore dhe njëkohësisht që këtij procesi t'i ngritet kredibiliteti përmes asistencës britanike në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit për Pozitat e Larta Drejtuese të nënshkruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti dhe Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Nicholas Abbott, më datë 02.07.2020.

Një proces kredibil i përzgjedhjes së menaxhmentin e Ndërmarrjeve Publike nënkupton ngritje të performancës së NP-ve dhe shërbime më të mira për qytetarët, çka është edhe synim i Qeverisë së Kosovës si Aksionar.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria / Government of Kosovo Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit / Ministry of Economic Development			
Nr. i Org. Org. Unit	01	Nr. Prot. Prot. No.	696
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	2	Data Datum Date	03.07.20
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

DATA:	03.07.2020
PËR/ZA/TO:	Z. Blerim Kuçi, Ministër i Ekonomisë dhe Ambientit <i>M.K.</i>
CC:	Z. Bedri Berisha, Shef i Kabinetit të Ministrit
PËRMES /PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Z. Besnik Krasniqi, Udhëheqës i NJPMNP-së <i>B.Krasniqi</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë BD të NPQ-ve për pezullim të procesit të rekrutimit për pozitave të zyrtarëve të lartë në NP

I nderuar ministër z. Kuçi,

Mbështetur në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 5.1, Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore dhe në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si Ministri kemi përgjegjësi të qarta për performancën e Ndërmarrjeve publike.

Në periudhën e fundit, në NP, ndodhën ndryshime si pasojë e shkarkimeve, emërimeve të Bordeve të përkohshme të Drejtorëve me ç'rast u kontestua kredibiliteti i përzgjedhjes së Bordit të NP dhe të pozitave të zyrtarëve të lartë të përcaktuara me ligjin për ndërmarrjet publike, si pasojë e të cilave u ngritën ankesa dhe padi.

Lidhur me këtë situatë pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Ambasadën Britanike lidhur me përzgjedhjen e pozitave të larta drejtuese, NJPMNP ju drejtohet me qëllim që, në cilësi të aksionarit të kërkohet nga Ndërmarrjet Publike t'i pezullojnë konkurset respektivisht proceset e rekrutimit të pozitave të shpallura për zyrtarët e lartë të ndërmarrjeve publike deri në fillimin e implementimit të marrëveshjes së nënshkruar të bashkëpunimit me Ambasadën Britanike.

Kërkesa është imediate dhe Ndërmarrjet publike duhet të reflektojnë për pezullimin e konkurseve të shpallura lidhur me përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë, me qëllim të zbatimit të marrëveshjes tashmë të nënshkruar të bashkëpunimit me Ambasadën Britanike.

Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Ambasadën Britanike lidhur me përzgjedhjen e pozitave të larta drejtuese, brenda Institucioneve të Kosovës përfshin edhe pozitën e larta në ndërmarrje publike dhe në agjenci të tjera.

Duhet qartësuar se kjo marrëveshje reflekton përpjekjet e përbashkëta për të siguruar emërimet profesionale të udhëheqësve të institucioneve dhe organeve publike, nëpërmes proceseve të drejta transparente dhe konkurruese me qëllim të emërimit në këto pozita të kandidatëve me përgatitje profesionale dhe mbi baza meritore të cilat edhe pastaj do të ndikonin në përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve Publike.

Meqenëse, pozita për KE dhe zyrtarët e tjerë janë emëruar ushtrues të detyrës, duke konsideruar që kanë përgjegjësi të plotë në ushtrimin e obligimeve dhe përmbushjen e përgjegjësisë, mbështetur në objektivat e aksionarit që përzgjedhja në këto procese të bëhet në mënyrë transparente dhe në mbështetje të partnerëve, pezullimi i procesit rekrutues nuk do të shkakton prolongim të proceseve menaxheriale në ndërmarrje.

Respekt!